



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 823 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 279, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, neni 48 dhe neni 134, pika 1, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit dhe raportit të monitorimit, në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit mbi verifikimin në terren në kuadër të gjetjeve rastësore në zonën e Spitallës të qytetit të Durrësit”, realizuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
2. Gjetjet arkeologjike të dala do të depozitohen në Muzeun Arkeologjik të Durrësit;
3. Përgatitja e dosjeve për regjistrimin e tyre pranë Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore pas transportimit dhe dokumentimit të tyre në ambientet e Muzeut Arkeologjik të Durrësit;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

